



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 2818 prot.

Tiranë, më 18.06.2021

UDHËZIM

Nr. 296 datë 18.06.21

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 481, DATË 27.06.2019 "PËR PROCEDURAT E
PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË
NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 10
107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

Në udhëzimin nr. 481, datë 27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave
mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar",
bëhen këto ndryshime:

1. Pas germës g) pika 4, Kreu 2, shtohet germa h) me këtë përmbajtje:

"h) Komisioni i Vlerësimit monitoron procesin e përzgjedhjes së vendeve të lira të punës, më specifikisht:
njoftimin, ofrimin dhe përzgjedhjen e vendeve vakante për Profesionistët e Shkencave Mjekësore
Teknike."

2. Shkronja a), paragrafi i parë, Kreu 3, shtohet dhe bëhet:

"a) Vlerësimin e dosjes së kandidatëve që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të
lidhura me fushën, deri në 30 pikë. Brenda numrit total prej 30 pikë shtohet bonus si më poshtë:

- Studenteve të ekselencës 10 pikë,
- Profesionistëve të Shkencave Mjekësore Teknike që kanë punuar për diagnostikimin dhe trajtimin e pacienteve
të prekur nga COVID-19, në spitalet Covid 1, 2, 3 dhe 4 (të vertetuar me shkrim nga DROSHKSH Tiranë) për
një periudhë mbi tre muaj, 5 pikë.

3. Pika 3, Kreu 4, ndryshohet dhe bëhet:

"3. Për vendet e lira të punës për çdo NJVKSH, kandidati njoftohet nga Komisioni i Vlerësimit të
DROSHKSH-së përkatëse, në varësinë e së cilës është vendi vakant, përmes postës elektronike, mesazhit
në celular dhe telefonatave në adresat të cilat kandidati i ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe në
dosje".

4. Në Pikën 4, Kreu 4, togfjalëshi "DROSHKSH" zëvendësohet me togfjalëshin "Komisioni i
Vlerësimit".

5. Pika 9, Kreu 4, ndryshohet dhe bëhet:
"9. Në rast se do të ketë vende të lira pune të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët fitues në listën e pritjes për atë njësi, këto pozicione mund të plotësohen përkohësisht, vetëm atëherë kur është ezauruar lista e fituesve sipas qarkut përkatës. Pozicioni i lirë mund të plotësohet nga kandidatë të licencuar në profilin përkatës deri në punësimin e kandidatit fitues nga portali. Në këto raste NJVKSH i drejtohet me kërkesë DROSHKSH, e cila pas një vlerësimi e përcjell kërkesën për miratim emërimi të përkohshëm pranë DQOSHKSH".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Ogerta Manastirliu

